

BANKA E SHQIPËRISË

B U L E T I N I
Z Y R T A R

vëllimi 8 numër 2 shkurt 2006

Data e botimit 17.02.2006

P Ë R M B A J T J A

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.05, datë 08.02.2006 "Për një ndryshim në rregulloren "Mbi procedurat e ndërhyrjes së Bankës së Shqipërisë në tregun e brendshëm të këmbimeve valutore"" 5
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.08, datë 08. 02. 2006 "Për miratimin e deklaratës së Bankës së Shqipërisë "Mbi stabilitetin e sistemit financiar në Shqipëri"" 7
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.09, datë 08.02. 2006 "Për miratimin e dokumentit "Për misionin e Mbikëqyrjes"" 12
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.11, datë 08.02.2006 "Për prokurimin e drejtpërdrejtë të blerjes së karburantit, për nevoja të Bankës së Shqipërisë" 14
5. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 8, Numër 1, Janar 2006 15



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

Nr. 05, datë 08.02.2006

PËR

NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN "Mbi PROCEDURAT E
NDËRHYRJES SË BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E
BRENDSHËM TË KËMBIMEVE VALUTORE"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 61, shkronja "a" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" me propozimin e Departamentit të Operacioneve Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Në nenin 5 të rregullores "Mbi procedurat e ndërhyrjes së Bankës së Shqipërisë në tregun e brendshëm të këmbimeve valutore" miratuar me vendimin nr.38, datë 19.05.2005 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, bëhen ndryshimet e mëposhtme:
 - a) Pika 5.2 ndryshohet si më poshtë vijon:
"Në rastin kur objektivi i ndërhyrjes është i lidhur me pikën 3.2, shkronja "a" të kësaj rregulloreje, referuar nenit 43, shkronja "b" të ligjit "Për Bankën e Shqipërisë", organi vendimmarrës do të jetë Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë".
 - b) Pas pikës 5.2 shtohet pika 5.3 me përmbajtjen e mëposhtme:
"Në rastin kur objektivi i ndërhyrjes është i lidhur me pikën 3.2, shkronja "b" të kësaj rregulloreje, referuar nenit 43, shkronja "a" të ligjit "Për Bankën e Shqipërisë", organi vendimmarrës do të jetë Komiteti i Zbatimit të Politikës Monetare, i cili do të veprojë në përputhje me objektivat e Programit Monetar të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë".
2. Ngarkohen Departamenti i Operacioneve Monetare dhe të gjitha strukturat e tjera në Bankën e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritet Evropian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

KRYETARI

YLLI MEMISHA

ARDIAN FULLANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

Nr. 08, datë 08. 02. 2006

PËR
MIRATIMIN E DEKLARATËS SË BANKËS SË SHQIPËRISË “MBI
STABILITETIN E SISTEMIT FINANCIAR NË SHQIPËRI”

Në bazë dhe në zbatim të nenit 69, pika 6 të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë deklaratën “Mbi stabilitetin e sistemit financiar në Shqipëri”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritimit Evropian dhe Komunikimit për publikimin dhe dërgimin e deklaratës Kuvendit të Shqipërisë, Presidentit të Republikës, Këshillit të Ministrave, Ministrisë Financave dhe Ministrisë së Ekonomisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

KRYETARI

YLLI MEMISHA

ARDIAN FULLANI

BANKA E SHQIPËRISË KËSHILLI MBIKËQYRËS

DEKLARATË E BANKËS SË SHQIPËRISË “MBI STABILITETIN E SISTEMIT FINANCIAR NË SHQIPËRI”

Në mbështetje të kërkesës së ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” dhe të detyrimit për të tërhequr vëmendjen e institucioneve të vendit, të tregut financiar dhe të operatorëve të tij, si edhe të publikut, mbi rreziqet që mund të kërcënojnë qëndrueshmërinë e sistemit financiar dhe veçanërisht të atij bankar, në vend, Banka e Shqipërisë publikon këtë deklaratë periodike.

Banka e Shqipërisë vëren që nivelet e kënaqshme aktuale të kapitalizimit dhe të përfitueshmërisë së sistemit bankar, do të ndikojnë në ruajtjen e qëndrueshmërisë së tij edhe për periudhën e ardhshme. Në të njëjtën kohë, Banka e Shqipërisë konstaton se forcimi i kushteve të konkurrencës në treg, i shoqëruar me rritjen me ritme të larta të kredidhënies, shton mundësitë për të gjallëruar disa elemente të rrezikut që lidhen me rënien e cilësisë së portofolit të kredive. Këto rreziqe kërkojnë një monitorim të kujdesshëm dhe të vazhdueshëm nga ana e strukturave përkatëse të bankave, në mënyrë që të mos materializohen dhe të mos bëhen të rëndësishme në veprimtarinë e sistemit bankar.

Në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2005, u evidentuan zhvillime pozitive në sistemin bankar, me përfitime të cilat janë ndjerë në një mënyrë më konkrete dhe në një shkallë më të lartë nga klientët e bankave dhe nga ekonomia në përgjithësi. Konkretisht:

- a) ka vijuar zgjerimi i kreditimit në forma të larmishme për t’iu përshtatur më mirë kërkesave të tregut. Cilësia e kredisë mbetet e mirë dhe kriteret aktuale të bankave në dhënien e saj përfaqësojnë një bazë të shëndoshë për ruajtjen e kësaj cilësie edhe në të ardhmen. Banka e Shqipërisë, mendon se ritmet aktuale të rritjes së kreditimit, e bëjnë të domosdoshëm forcimin e sistemeve të kontrollit dhe të strukturave përkatëse në bankat tregtare. Një element i nevojshëm që do të ndikojë në forcimin e kapaciteteve analizuese të bankave tregtare në procesin e dhënies së kredisë, është edhe krijimi dhe vendosja në funksionim e Zyrës së Informacionit të Kredive. Banka e Shqipërisë është e vendosur të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm, në bashkëpunim me institucionet financiare ndërkombëtare, me autoritetet dhe me industrinë bankare në vend, në mënyrë që të mundësojë vendosjen në funksionim në një kohë sa më shpejtë të këtij instrumenti monitorues;
- b) lëvizjet e normave të interesit në treg janë absorbuar me lehtësi nga mjedisi i përgjithshëm ekonomik dhe veprimtaria e operatorëve të tregut financiar, duke ruajtur në këtë mënyrë kushte të favorshme që sistemi bankar dhe ai financiar në përgjithësi, të asistojnë më mirë zhvillimin ekonomik të vendit;
- c) sistemi bankar ka realizuar një veprimtari fitimprurëse dhe është paraqitur i mirëkapitalizuar;
- d) sistemi bankar, ka vijuar të zgjerohet në të gjithë vendin nëpërmjet

- hapjes së degëve dhe të agjencive të reja. Në fund të muajit dhjetor 2005, numri i degëve funksionale të sistemit bankar arriti në 131, ndërsa numri i agjencive funksionale të tij arriti në 117;
- e) në fund të vitit, u licencua dhe filloi veprimtarinë edhe një bankë e re me kapital shqiptar, Banka Union. Numri i përgjithshëm i bankave arriti në 17;
- f) është rritur interesi i kapitalit të huaj, për të investuar në sistemin bankar në Shqipëri. Kështu, është përfunduar procesi i ndryshimit të pronësisë së ish-bankës Dardania (aktualisht, Banka Italiane e Zhvillimit), si edhe ka përparuar ndjeshëm procesi i shitjes së aksioneve të Shtetit Shqiptar në Bankën Italo-Shqiptare. Njëkohësisht, ka patur lëvizje të institucioneve bankare për të siguruar një strukturim më të mirë të veprimtarisë, nëpërmjet aplikimit për ndryshim të formës së organizimit të tyre (rasti i Degës në Tiranë të Bankës së Parë të Investimeve).

Ndër treguesit kryesorë financiarë të sistemit bankar për periudhën e kaluar, përmendim:

Treguesi	qershor '05	dhjetor '05 *
Mjaftueshmëria e kapitalit	19.80%	18.90%
Kapitali aksioner (milionë lekë)	30,653.20	34,506.50
Rezultati neto (milionë lekë)	3,316.54	6,626.70
Kredia e re (milionë lekë)	54,961.00	104,842.00
Kredia me probleme neto/kredia neto	0.75%	0.83%
Kredia me probleme, bruto/totali i bilancit	0.50%	0.55%
* Për muajin dhjetor janë të dhëna operative.		

Në kuadër të bashkëpunimit ndër-institucional, edhe në gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2005, Banka e Shqipërisë ka forcuar bashkëpunimin me institucione të tjera brenda vendit, të cilat ushtrojnë funksione mbikëqyrëse në segmente të caktuara të tregut financiar. Veçojmë bashkëpunimin me Autoritetin Mbikëqyrës të Sigurimeve dhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave në Ministrinë e Financave. Në vazhdimësi, është përmirësuar mënyra e komunikimit me bankat duke shfrytëzuar më mirë ndihmën që ka dhënë në këtë drejtim Shoqata Shqiptare e Bankave, si një organizim i cili mundëson paraqitjen e unifikuar të opinioneve të bankave për çështje të ndryshme që lidhen me veprimtarinë e tyre dhe me ndërveprimin me institucione të tjera. Banka e Shqipërisë kërkon që ky bashkëpunim të vijojë edhe në të ardhmen, për çështje të rëndësishme të sistemit bankar dhe financiar.

Banka e Shqipërisë mbështet përpjekjet e autoriteteve shtetërore dhe të institucioneve financiare ndërkombëtare në zhvillimin e tregut financiar në vend dhe është e vendosur të luajë një rol aktiv në këtë proces. Masat për zgjerimin e sektorit formal të ekonomisë dhe shmangien e evazionit fiskal, si edhe krijimi i një autoriteti mbikëqyrës të integruar për institucionet financiare që nuk licencohen nga Banka e Shqipërisë, janë elemente të rëndësishme që mbështesin zhvillimin e një veprimtarie ekonomike në kushtet e konkurrencës së ndershme dhe që synojnë përcaktimin dhe zbatimin e një kuadri të plotë rregullativ, dhe rritjen e përgjegjshmërisë e të eficiencës në kryerjen e funksionit mbikëqyrës,

në segmente të caktuara të tregut financiar. Nga ana e saj, Banka e Shqipërisë do të vazhdojë bashkëpunimin me Ministrinë e Financave dhe me industrinë bankare, për të përmirësuar procesin e planifikimit, të kryerjes së ankandëve dhe të krijimit të një tregu efektiv në tregtimin e instrumenteve të borxhit të brendshëm të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë. Qëllimi është që tregu dhe institucionet e tij, të marrin një rol më të madh në tregtimin e këtij borxhi tek publiku.

Për përmirësimin e funksionimit të tregjeve financiare, Banka e Shqipërisë konstaton nevojën për përmirësime ligjore dhe rregullative në drejtimet e mëposhtme:

- a) me miratimin e ligjit nr.9396, datë 12.05.2005 "Për qiranë financiare", ka lindur nevoja e përcaktimit të kuadrit rregullativ përkatës dhe të autoritetit mbikëqyrës për çdo institucion që do të ushtrojë këtë veprimtari në zbatim të këtij ligji. Në mbështetje të kërkesave të ligjit, Ministria e Financave dhe Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës, ngarkohen me këtë detyrë. Në këtë kuadër, Banka e Shqipërisë mendon se është e nevojshme që në këto akte nënligjore që do të nxirren, të përcaktohet saktë edhe koncepti "institucione/subjekte financiare", pasi një përcaktim i tillë mungon. Banka e Shqipërisë, gjykon se është e nevojshme që këto institucione të veprojnë në mënyrë sa më të shpejtë, për të mbyllur një boshllëk rregullativ dhe institucional mbikëqyrës, për subjektet që kryejnë veprimtarinë financiare në zbatim të ligjit të mësipërm. Në këtë mënyrë, do të shmangej çdo rrezik që mund të vijë nga kryerja e një veprimtarie të pambikëqyruar, si edhe do të veprohej në përputhje me rekomandimet e institucioneve financiare ndërkombëtare, që asistojnë zhvillimin e tregut financiar në Shqipëri, për institucione të mirërregulluara dhe të mbikëqyruara;
- b) në kuadër të elementeve të cilat zbusin rrezikun e mundshëm në veprimtarinë kredituese, një rol të rëndësishëm luan edhe ekzistenca e procedurave të shpejta në ekzekutimin e pasurive të paluajtshme, të vendosura nga kredimarrësi si kolateral për garantimin e vlerës së kredisë. Praktika bankare ka treguar se në këto procedura është e nevojshme të kryhen disa përmirësime, si më poshtë:
 - në nenin 564 të Kodit të Procedurës Civile, ku të përcaktohet që vlerësimi i sendit të sekuestruar të kryhet nga ekspertë vlerësues të pavarur, të zgjedhur nga Zyra e Përmbarrimit. Në këtë mënyrë, shkurtohen procedurat e panevojshme të ankimit ndaj vlerësimit fillestar të sendit;
 - në nenin 577 të Kodit të Procedurës Civile, ku të parashikohet shkurtimi i afatit kohor midis dy ankandëve nga tre në një muaj; kreditorit (bankës) t'i njihet e drejta e posedimit të sendit pa patur detyrimin për kthimin e diferencës së vlerës së sendit; kreditorit (bankës) t'i njihet e drejta për të tjetërsuar (shitur) sendin me një vlerë më të ulët se në ankandin e parë dhe; të parashikohet ruajtja e sekuestros mbi sendin dhe të njihet e drejta e kreditorit (bankës) për hapjen e procedurës së ekzekutimit kur kushtet e tregut të jenë në favor të tij.
 - Këto ndryshime, duhet të shoqërohen me ndryshime të tjera në

ligjin “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe në kuadrin rregullativ përkatës. Gjithashtu, është i nevojshëm hartimi i ligjit “Për procedurat e ankandit”, i cili parashikohet në nenin 573, paragrafi 4 të Kodit të Procedurës Civile;

- c) ky vit përfaqëson periudhën kur duhet të përfundojë rishikimi i ligjit ekzistues nr.8365, datë 02.07.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”. Shfrytëzimi i përvojës së vendeve që janë pranë integritit në Bashkimin Evropian, ndihma e institucioneve financiare ndërkombëtare, si edhe diskutimi i gjerë që do të zhvillohet rreth këtij projekti me industrinë bankare, do të bëjnë të mundur adoptimin e një projektligji i cili do të përmirësojë në mënyrë të ndjeshme mënyrën e veprimit dhe të mbikëqyrjes së institucioneve që kryejnë veprimtari bankare.

Banka e Shqipërisë beson se periudha deri në fund të vitit 2006, do të vijojë të dëshmojë normalitet në veprimtarinë e sistemit bankar dhe financiar, në ecurinë e vazhdueshme drejt konsolidimit dhe qëndrueshmërisë së tij.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

Nr. 09, datë 08.02. 2006

PËR

MIRATIMIN E DOKUMENTIT "PËR MISIONIN E MBIKËQYRJES"

Në bazë dhe në zbatim të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë dokumentin "Për misionin e mbikëqyrjes", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.11, datë 08.02.2005, shfuqizohet.
3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritimit Evropian dhe Komunikimit, për publikimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

KRYETARI

YLLI MEMISHA

ARDIAN FULLANI

DOKUMENTI "PËR MISIONIN E MBIKËQYRJES"

Funksioni i mbikëqyrjes ushtrohet nga Banka e Shqipërisë, si bankë qendrore, në bazë të ligjit "Për Bankën e Shqipërisë" nr. 8269, datë 23.12.1997 dhe të ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" nr. 8365, datë 02.07.1998.

MISIONI I MBIKËQYRJES

Banka e Shqipërisë, në zbatim të përgjegjësive ligjore si autoriteti mbikëqyrës i bankave dhe i subjekteve të tjera, që kryejnë veprimtari financiare të licencuara prej saj:

- siguron veprimtari të shëndoshë bankare në harmoni të plotë dhe në zbatim të kuadrit ligjor e rregullativ përkatës, me qëllim parandalimin e krizave financiare dhe mbrojtjen e depozituesve;
- ruan stabilitetin e sistemit bankar dhe më gjerë, duke monitoruar zhvillimet e tregut dhe duke rekomanduar masat e nevojshme, në mënyrë që bankat t'iu përshtaten këtyre zhvillimeve dhe të administrohen në vazhdimësi sipas parimeve më të mira;
- forcon besimin e publikut tek sistemi bankar si edhe nxit disiplinën e tregut, duke kërkuar rritjen e transparencës së sistemit bankar;
- ndikon në zhvillimin e një konkurrence të ndershme në sistemin bankar dhe më gjerë, dhe siguron trajtimin e barabartë të subjekteve të licencuara dhe të klientëve të tyre;
- ofron një komunikim të vazhdueshëm profesional ndaj operatorëve të tregut financiar si edhe ndaj institucioneve të tjera që ndikojnë në veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë, në kuadër të përmirësimit të funksionimit të tregut financiar dhe të operatorëve të tij.

Banka e Shqipërisë, e realizon funksionin e saj mbikëqyrës, nëpërmjet:

- a) ndërtimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të kuadrit rregullativ mbikëqyrës, në mënyrë që ai të jetë në harmoni me parimet më të mira ndërkombëtare dhe i zbatueshëm në praktikë;
- b) inspektimeve në vend dhe analizës së treguesve të institucioneve të licencuara, si edhe ndërmarrjes së veprimeve korrektuese për zgjidhjen e problemeve të ndryshme;
- c) orientimit të procesit mbikëqyrës drejt identifikimit të rrezikut me të cilin ndeshen institucionet e licencuara, duke rekomanduar zgjidhjet përkatëse;
- d) ndërtimit të politikave, të cilat synojnë orientimin e sistemit bankar drejt zhvillimeve të dëshiruara;
- e) bashkëpunimit me institucionet financiare që mbikëqyren, me institucione të tjera financiare brenda vendit si edhe me autoritetet mbikëqyrëse të vendeve të tjera;
- f) përmirësimit të vazhdueshëm të kapaciteteve mbikëqyrëse.

Në zbatimin e kërkesave të funksionit mbikëqyrës, Banka e Shqipërisë synon nivelet më të larta të integritetit, të profesionalizmit, të eficiencës dhe të transparencës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

Nr. 11, datë 08.02.2006

PËR

“PROKURIMIN E DREJTPËRDREJTË TË BLERJES SË KARBURANTIT, PËR
NEVOJA TË BANKËS SË SHQIPËRISË”

Në bazë dhe në zbatim të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, neni 43, shkronjat (g) dhe (j), si dhe të nenit 3 të rregullores “Për prokurimin e mallrave, të shërbimeve dhe të ndërtimeve në Bankën e Shqipërisë”, miratuar me vendimin nr. 15, datë 26.02.2003, megjithë ndryshimet e saj, me propozimin e Departamentit të Administrimit dhe të Kryetarit të Entit Prokurues, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratoje procedurën “ Prokurimi i drejtpërdrejtë ” për blerje karburanti, për nevoja të Bankës së Shqipërisë.
2. Fondi limit për realizimin e këtij objekti të jetë 7.150.000 lekë.
3. Ngarkohet Departamenti i Administrimit me zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritimit Evropian dhe Komunikimit, për publikimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

KRYETARI

YLLI MEMISHA

ARDIAN FULLANI

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR VËLLIMI 8, NUMËR 1,
JANAR 2006

1. Vendim nr.01, datë 25.01.2006 "Për miratimin e deklaratës së politikës monetare të Bankës së Shqipërisë për gjashtëmuorin e dytë të vitit 2005".
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.02, datë 25.01.2006 "Për miratimin e rregullores "Për ekspozimin e vlerave numizmatike në Bankën e Shqipërisë dhe administrimin e ruajtjen e tyre"".
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.03, datë 25.01.2006 "Për dhënien e miratimit paraprak të licencës për të ushtruar veprimtari bankare, bankës së propozuar "Banka e Parë e Investimeve – Shqipëri sh.a."".
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.04, datë 25.01.2006 "Për caktimin e kontrollorëve të jashtëm për auditimin e aktivitetit të Bankës së Shqipërisë".

